

VENDIM
Nr.58, datë 3.6.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S
NR.9, DATË 25.1.2008 “PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË OSSH SHA”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “ç” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë, elektrike”, të ndryshuar, pikës 2, paragrafi 12, të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.6.2008, mbasi shqyrtoi propozimin për ndryshimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 25.1.2008 “Për dhënien e licencës për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike shoqërisë OSSH sh.a.”

dhe konstatoi se:

- Modeli i tregut të energjisë elektrike parashikon si pjesëtar të tregut të energjisë elektrike furnizuesin publik me pakicë, i cili do të funksionojë si një njësi e OSSH sh.a. e ndarë funksionalisht dhe financiarisht,
- OSSH sh.a. është mbajtëse e licencës për furnizimin me energji elektrike të klientëve tariforë,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.9, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licencës për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike shoqërisë OSSH sh.a.” në pikën 1, pas fjalës furnizimit shtohen fjalët:

– publik me pakicë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ta njoftojë shoqërinë OSSH sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta